



Tiranë, më 28/02/2026

Nr. 70 Prot



Tiranë, më 28/02/2026

Nr. 305 Prot

**MARRËVESHJE KUADËR BASHKËPUNIMI
NDËRMJET
AKADEMISË SË SHKENCAVE TË SHQIPËRISË (ASHSH)
DHE
URDHRI PROFESIONAL I MJEKUT VETERINAR TË SHQIPËRISË**

E mbajtur sot më datë, 28.02. 2026, bazuar në vullnetin e lirë të palëve.

Palët:

Akademia e Shkencave e Shqipërisë, (në vijim ASHSH), me qendër në Tiranë, Shëtitorja “MuratToptani”, është institucioni më i lartë shkencor në Republikën e Shqipërisë, i krijuar dhe funksionon në bazë të ligjit nr. 53/2019 “Për Akademinë e Shkencave të Shqipërisë”, me mision zhvillimin, promovimin dhe koordinimin e kërkimit shkencor, përparimin e dijes dhe këshillimin shkencor të politikave publike, e përfaqësuar nga Kryetari i Akademisë së Shkencave, Akad. Skënder Gjinushi.

dhe

Urdhri Profesional i Mjekut Veterinar të Shqipërisë, (në vijim UPMVSH), me adresë: rruga “MyslymKeta”, 1001, Tiranë, me Numër Unik të Identifikimit të Subjektit (NIPT/SSN) L61727452J, është ent publik profesional, i pavarur, themeluar në vitin 2016, i cili funksionon bazuar në ligjin nr. 113/2015 “Për Urdhrin Profesional të Mjekut Veterinar dhe Statutin e Urdhrit Profesional të Mjekut Veterinar të Shqipërisë”, i përfaqësuar nga Presidenti Ervin Resuli.

Të dy institucionet, me synimin e përbashkët dhe vullnetin e tyre të lirë, pajtohen të bashkëpunojnë në funksion të zhvillimit shkencor, profesional dhe institucional në fushën e mjekësisë veterinare dhe shkencave të lidhura në përputhje me misionin dhe vizionin e tyre si më poshtë:

1. ASHSH është institucioni kryesor në vend për zhvillimin e kërkimit shkencor, përfshirë shkencat biologjike, bujqësore, mjedisore dhe veterinare, si dhe për promovimin e standardeve shkencore dhe etikë në veprimtarinë kërkimore.

2. ASHSH inkurajon studimin ndërdisiplinor dhe multidisiplinor, shkëmbimin e rezultateve kërkimore, organizimin e veprimtarive shkencore dhe forcimin e lidhjeve midis komunitetit shkencor dhe profesionistëve.
3. UPMVSH ka si mision ruajtjen e standardeve të larta profesionale në formimin, sjelljen dhe ushtrimin e profesionit të mjekut veterinar, duke garantuar mbrojtjen e shëndetit dhe mirëqenies së kafshëve dhe të shëndetit publik.
4. UPMVSH organizon edukimin në vazhdimësi të mjekëve veterinarë, trajnime profesionale, certifikim të aftësive dhe zbatimin e kërkesave higjieno-veterinare në përputhje me legjislacionin në fuqi.

NENI 1

Qëllimi i marrëveshjes

1. Qëllimi i kësaj Marrëveshjeje Bashkëpunimi është përcaktimi i fushave dhe modaliteteve të bashkëpunimit ndërmjet ASHSH dhe UPMVSH.
2. Palët synojnë nxitjen dhe zhvillimin e kërkimit shkencor në fushat përkatëse, forcimin e bashkëpunimit ndërmjet komunitetit shkencor dhe profesionistëve të mjekësisë veterinare, si dhe mbështetjen shkencore të edukimit profesional në vazhdimësi, me qëllim përmirësimin e praktikave veterinare në përputhje me standardet kombëtare dhe ndërkombëtare.

NENI 2

Angazhimet e palëve dhe format e bashkëpunimit

Bashkëpunimi ndërmjet palëve do të përfshijë:

1. Kontributin e Akademisë së Shkencave të Shqipërisë me ekspertizë shkencore, studiuere dhe akademike në veprimtari kërkimore, këshillimore dhe edukuese, në mbështetje të veprimtarisë profesionale të UPMVSH;
2. Bashkëorganizimin e konferencave, simpoziumeve, tryezave shkencore dhe seminareve profesionale, me interes të përbashkët shkencor dhe profesional;
3. Nxitjen, zhvillimin dhe realizimin e projekteve të përbashkëta kërkimore kombëtare dhe ndërkombëtare në fushën e mjekësisë veterinare, shëndetit publik, sigurisë ushqimore dhe mirëqenies së kafshëve;
4. Shkëmbimin e literaturës shkencore, studimeve, analizave dhe publikimeve kërkimore me interes të ndërsjellë;
5. Bashkëpunimin për hartimin e opinioneve, rekomandimeve, raporteve dhe dokumenteve shkencore me interes publik, si dhe për ofrimin e këshillimit shkencor të specializuar.

6. Përfshirjen dhe mbështetjen e studiuesve të rinj, profesionistëve dhe ekspertëve në aktivitete shkencore, kërkimore dhe profesionale;
7. Çdo formë tjetër bashkëpunimi që palët, me marrëveshje të përbashkët, e konsiderojnë të nevojshme dhe të dobishme për arritjen e objektivave të kësaj marrëveshjeje.

NENI 3

Kohëzgjatja e Marrëveshjes dhe e drejta e tërheqjes

1. Kjo Marrëveshje lidhet dhe do të mbetet në fuqi për një afat të pacaktuar, duke nisur nga data e nënshkrimit të saj.
2. Palët kanë të drejtën të tërhiqen nga marrëveshja duke bërë kërkesë me shkrim brenda një afati 3 (tre) mujor përpara prishjes së marrëveshjes, duke dhënë arsyen ligjore. Në rast të tërheqjes, Palët bien dakord që të përfundojnë aktivitetet në vazhdim në lidhje me Marrëveshjet e Zbatimit të përcaktuara tashmë në datën e tërheqjes, përveç rasteve të ndryshme të përcaktuara me Marrëveshje të Zbatimit individuale.
3. Në rastin e kërkesës me shkrim për tërheqje, efektet juridike të marrëveshjes shtrihen deri në momentin që prishet marrëveshja.
4. Në qoftë se afati i caktuar për kryerjen e detyrimit të njëra palë është thelbësor për interesin e palës tjetër, kjo e fundit kur dëshiron të kërkojë zbatimin pavarësisht prishjes së marrëveshjes, duhet t'i bëjë njoftim palës tjetër brenda tri ditëve, përveç marrëveshjes së kundërt.

NENI 4

Kontributet dhe shpenzimet ekonomike

1. Të dy palët bien dakord që realizimi i veprimtarive të mësipërme të kryhet në varësi të burimeve financiare dhe potencialit të disponueshëm nga secili institucion.
2. Kjo Marrëveshje Bashkëpunimi nuk ka implikime financiare nga cilado palë, megjithatë marrëveshjet specifike dhe eventuale financiare për aktivitetet të veçanta do të përcaktohen paraprakisht, nëse ka raste të tilla.

NENI 5

Standardet dhe Konfidencialiteti

1. Të dyja palët janë të detyruara të përmbushin kushtet e Marrëveshjes me ndershmëri (integritet) të lartë dhe standarde profesionale, etike dhe kompetence.
2. Me anë të nënshkrimit të kësaj marrëveshjeje, palët zotohen të ruajnë konfidencialitetin.

NENI 6

Ndryshimi, plotësimi i marrëveshjes dhe zgjidhja e mosmarrëveshjeve

1. Kjo Marrëveshje Bashkëpunimi është dokumenti bazë ndërmjet palëve dhe çdo ndryshim ose plotësim i saj bëhet vetëm me dakordësinë e ndërsjellë dhe me nënshkrim me shkrim nga palët.
2. Çdo marrëveshje e veçantë që lidhet me organizime specifike dhe me të drejta e detyrime reciproke është e vlefshme vetëm nëse përpilohet me shkrim dhe nënshkruhet nga përfaqësuesit e autorizuar të palëve.
3. Çdo mosmarrëveshje që lind nga interpretimi ose zbatimi i kësaj Marrëveshjeje zgjidhet fillimisht me mirëkuptim, përmes negociatave dhe komunikimit zyrtar me shkrim.
4. Në rast të pamundësisë së zgjidhjes me mirëkuptim, palët i drejtohen Gjykatës kompetente, duke u referuar legjislacionit në fuqi.

NENI 7

Hyrja në fuqi

Kjo marrëveshje hyn në fuqi menjëherë pas nënshkrimit të saj.

Marrëveshja hartohet në gjuhën shqipe në 4 (katër) kopje origjinale nga dy për secilën palë, të cilat pasi lexohen nga palët, firmosen prej tyre me vullnet të lirë e të plotë dhe vulosen.

Për:

| | |
|--|---|
| <p>Akademini e Shkencave të Shqipërisë</p> <p>Kryetari Akad. Skënder Gjinushi</p>   | <p>Urdhrin Profesional i Mjekut Veterinarë të Shqipërisë</p> <p>Presidenti Z. Ervin Resuli</p>   |
|--|---|